



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

Nr. 726 Prot

Shkodër, më 13/6 / 2016

VENDIM

NR 358 datë 13.6.2016

Në mbështetje të nenit 8, 9 të ligjit nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", ligjit Nr. 44/2015 Kodi I Proçedurave Administrative I Republikës së Shqipërisë" neni 29,

VENDOSI :

1. Delegim e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë, Z. Fatbardh Sheqi, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Shkodër, për të firmosur çdo korespondence shkresore që ka të bëjë me institucione publike, persona juridik ose fizik dhe individë për Drejtoritë si më poshtë, të cilat janë varësi direkte të Zv/Kryetarit Z.Fatbardh Sheqi , si më poshtë :
 - Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit
 - Zyra me Një Ndalesë
 - Sektori i Protokoll-Arkivit,
2. Për çdo shkresë e cila ndodhet e depozituar pranë Arkivës së Bashkisë Shkodër , për të cilat bëhen kërkesa nga subjekte të ndryshme për tu pajisur me dokumentacion , ka të drejtën, Z. Fatbardh Sheqi të bëjë njësimin me origjinalin e dokumentacionit të depozituar në sektorin e protokoll arkives të Bashkisë Shkodër, pas konfirmimit nga nëpunësit e Sektorit të Protokoll - Arkivës
3. Per zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Z.Fatbardh Sheqi, Drejtoria e Teknologjisë dhe Sistemeve të Informacionit, Zyra me Një Ndalesë, Sektori i Protokoll-Arkivit, të Bashkisë Shkodër.
4. Ky Urdhër hyn ne fuqi që nga data e firmosjes.

KRYETAR

Voltana ADEMI